Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Komuna Drenasit
Municipality Drenas
Kuvendi i Komunës

02 **Nr.**- 400/01- 46787 **dt.** 30/10/ **2026**

Bazuar në nenit 12 paragrafi 2 pika d), neni 17 pika i) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28, datë: 04. Qershor 2008, nenit 34 të Statutit të Komunës së Drenasit. Kuvendi i Komunës së Drenasit në mbledhjen e mbajtur me datë 29.10.2026 miratoi këtë:

DEKLARATË MBËSHTETËSE

I. Kuvendi i Komunës së Drenasit shpreh mbështetjen e plotë për Deklaratën mbi eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, e cila është miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 19 nëntor 2024 dhe e nënshkruar nga 66 deputetë të Legjislaturës së VIII.

II. Kuvendi i Komunës së Drenasit mbështet gjithashtu Komunikatën Mbështetëse të datës 14 korrik 2025, të nënshkruar nga anëtarë të kuvendeve komunale në nivel rajonal, përfaqësues të shoqërisë civile dhe institucioneve të tjera publike, në kuadër të takimit të organizuar nga Misioni i OSBE-së, të mbajtur në Gjilan.

III. Me këtë vendim, Kuvendi i Komunës angazhohet për forcimin e bashkëpunimit institucional dhe shoqëror me qëllim parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike.

IV. Kuvendi i Komunës obligon strukturat përkatëse komunale, përfshirë Kryesuesin e Kuvendit Komunal, Kryetarin e Komunës dhe Zyrën për Barazi Gjinore, që të promovojnë Deklaratën dhe parimet e saj përmes aktiviteteve informuese, komunikimit publik dhe bashkëpunimit me shoqërinë civile dhe partnerët relevant.

V. Ky vendim hyn në fuqi 30 (tridhjetë) ditë nga dita e regjistrimit dhe vlerësimit të ligjshmërisë nga MAPL-ja, si dhe 7 ditë nga publikimi në Ueb faqen zyrtare të Komunës.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

Burim Bujupi

Vendimi i dërgohet:
- Zyrës së Kryetarit ;
- Drejtorisë Përkatëse;
- Zyrës së Kuvendit;
- Arkivit

HYRËSE - IZLAZNA - OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration
Nr. Br. No. 020-692/4
Data Datum Date 04. 11. 2026
-VI-

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	**Ramiz Lladrovci**, Kryetar i Komunës së Gllogocit **Burim Bujupi**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gllogocit	
Kopje:	**Elbert Krasniqi**, Ministër në MAPL	
	Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësia për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Nga:	**Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	Datë:03.11.2026 -VI-020-692
Zyrtarët përgjegjës: 1. Zyrtari përgjegjës për përcjelljen e aktit në Komunë 2. Zyrtari përgjegjës për hartimin e shkresës përcjellëse	**Erblin Hetemi**, Drejtor i Departamentit Ligjor, MAPL **Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Kuvendit të Komunës dhe Kryetarit **Diturie Bekteshi**, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve Komunale DBekteshi	
Lënda:	Shkresë përcjellëse	
Lloji i aktit:	Deklaratë	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 8, të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Rregullores (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, marrë parasysh se ky vendim nuk bënë pjesë të vendimet e përgjithshme të kuvendit të komunës vlerëson se:

- *Deklarata 02 Nr.400/01-46787 për parandalimin dhe eliminimin e të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë dhe në jetën publike, nuk i nënshtrohet shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmërisë.*

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të Komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.